



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

**VENDIM NR 109 Datë 30.07.2020**

**Miratimi i Veprimtarisë Kulturore “O MIRE SE NA ERDHE”**

Mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015“Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, germa m, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe kërkesës Presidenti i Shoqatës Kulturore Artistike Ansambli Kuvendi i Zall-Dardhës , i paraqet Këshillit Bashkiak në mbledhjen e rradhës kërkesen për: Vendosjen e 1 Gushtit si festë tradicionale e kultures shpirtërore dhe materiale të krahinës së Dardhës, Këshilli Bashkiak në pikën të ndryshme me propozim të kryetarit të këshillit shqyrtuan kërkesën e ardhur nga Presidenti i Shoqatës Kulturore Artistike Ansambli Kuvendi i Zall-Dardhës. Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e tij, datë 30.07.2020 me 17 vota pro 2 vota kundër.

**VENDOSI :**

1. Miratimi i Veprimtarisë Kulturore 1 Gushtit si festë tradicionale e kultures shpirtërore dhe materiale të krahinës së Dardhës “O MIRË SE NA ERDHE”
2. Krahina e Zall-Dardhës është me tradita kulturore të njohura në mbarë vendin . Ansambli Kuvendi i Zall-Dardhës është ai që e ka bërë më të njohur dhe të vlersuar si brënda ashtu dhe jashtë vendit.Drejtimesit e këtij Ansambli,këngëtarë dhe valltare si dhe mendimi i shumë emigranteve nga kjo trevë bën që të marim iniciativën që kjo festë të shënohet në kalendarin e festave te Bashkise Dibër . Vendosjen e 1 Gushtit si festë tradicionale e kultures shpirtërore dhe materiale të krahinës së Dardhës “O MIRË SE NA ERDHE”ngre vlerat e vendit dhe ruan traditën e kësaj zone.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtori i Qendrës Kulturore Dibër ne bashkpunim me Presidentin e Shoqatës Kulturore Artistike Ansambli Kuvendi i Zall-Dardhës.
4. Vendimi u shpall sot me datë 30.07.2020

Kryetar Këshilli

Sokol Sava

